



**MSC. ING. LEDIO
KOSTA**

Asistent Lektor
Departamenti i Arkitekturës
dhe Dizajnit

Koordinator
në "Smart City Forumin"

KONTAKTE

✉ l.kosta@umb.edu.al



MSC. ING. LEDIO KOSTA

Asistent Lektor
Departamenti i Arkitekturës
dhe Dizajnit

Koordinator
në "Smart City Forumin"

BIOGRAFIA

Inxhinier i Shkencave Master, Ledio Kosta, është pjesë e laboratorit Smart City Lab, koordinator në "Smart City Forum" dhe i angazhuar si asistent lektor në Fakultetin e Arkitekturës dhe Industrive Kreative, pranë Departamentit të Arkitekturës dhe Dizajnit.

Është diplomuar në vitin 2013 në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike si inxhinier mekanik, dhe më pas ka ndjekur studimet në Fakultetin e Fizikës në Carl von Ossietzky Universität në Gjermani. Po atë vit ka përfunduar specializimin në fushën e energjive të rinovueshme pranë Institutit PROMES, pjesë e Qendrës Kombëtare për Kërkim në Energji Diellore (CNRS) në Perpignan, Francë.

Fokusi i specializimit të tij ka qenë optimizimi i impianteve të energjisë diellore me përqendrim (CSP) dhe përmirësimi i performancës energjetike në industri. Ka qenë pjesëtar i grupit të shërbimeve të konsulencës pranë Energy Community, në programet e efikasitetit të energjisë, deri në vitin 2020. Ka eksperiencë didaktike në fushën e projektimit të impianteve termike në ndërtesa dhe të impianteve për mbrojtje kundër zjarrit, duke përdorur programe që funksionojnë sipas metodologjisë Building Information Modelling (BIM). Si inxhinier mekanik projektues i licencuar që nga viti 2019, ka marrë pjesë në projekte të ndryshme impiantistike në Shqipëri.